



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 22.09.2022, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 12.09.2022.
2. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Smart Trade and Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017.
3. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Bindi” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017.
4. Mbi licencimin e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, Fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku i Fierit.
5. Mbi licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
6. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a..
7. Mbi një ndryshim në vendimin nr. 194, datë 21.07.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Green Energy Bilisht” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën Bitinckë, Bilisht, Qarku Korçë me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25 vjeçar”.